



Raport monitorues 14-të

mbi punën e ekzekutivit të komunës së

Lipjanit

Dhjetor 2016



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT

Përmbajtja:

Hyrje,	Faqe 2
Përmbledhje ekzekutive,	Faqe 3
Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti,	Faqe 4
Problemet aktuale,	Faqe 11
Transparenca dhe llogaridhënia	Faqe 11
Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit	Faqe 11
Drejtoria e prokurimit	Faqe 13
Arsimi	Faqe 17
Shëndetësia	Faqe 18
Tatimi në pronë	Faqe 18
Burimet:	Faqe 18

Lista e tabelave:

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.	Faqe 5
Tabela 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve	Faqe 10
Tabela 3. Buxheti komunal i planifikuar 2016	Faqe 12
Tabela 4. Buxheti komunal 2003/2016	Faqe 12
Tabela 5. LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUdhës JANAR-NËNTOR 2016	Faqe 14
Tabela 6. Numri i nxënësve dhe i personelit arsimor në Komunën e Lipjanit	Faqe 18

Lista e grafikoneve:

Grafiku 1. Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit IMRI AHMETI për realizimin e premtimeve	Faqe 8
Grafiku 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve	Faqe 8
Grafiku 3. Dinamika e realizimit të premtimeve nëpër vite 2014-2016	Faqe 10
Grafiku 4. Të hyrat komunal nga lloji i burimit	Faqe 12
Grafiku 5. Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Prokurimit	Faqe 13

Adresa: Rr."Tahir Sinani" 14000 Lipjan

Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140

e-mail: info.yahr@gmail.com

Ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>

<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

Facebook: <https://www.facebook.com/YAHR.Kosovo>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International Center"



OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) për gjatë pjesës së parë të vitit 2016 nëpërmjet monitoruesve të saj nga afër ka përcjellë punën e ekzekutivit si dhe funksionimin e legjislativit të komunës së Lipjanit. Ky monitorim ka pasur për qëllim të identifikojë jo vetëm të metat eventuale të qeverisjes si dhe shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi por edhe të shënojë ngritjen e institucioneve si në aspektin e rritjes së kapaciteteve, shfrytëzimit të buxhetit dhe aplikimit të frymës demokratike të marrjes së vendimeve si dhe të komunikimit dhe të transparencës.



Gjatë procesit të monitorimit YAHR-i ka synuar të rrisë besueshmërinë e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes por edhe të sigurojë një prani të përhershme të një mbikëqyrje transparente të funksionimit të pushteteve me theks të veçantë të transparencës në raport me qytetarin. Duke u nisur nga bindja se procesi i monitorimit është i domosdoshëm për këtë shkallë të zhvillimit të demokracisë sonë, derisa ende institucionet tona përballen me ngërçe institucionale dhe me mos-transparencë, YAHR-i konsideron se me punën e monitorimit është mundësuar një dobi e dyfishtë edhe në raport me institucionet por edhe me qytetarin. Institucionet komunale kanë pasur mundësi të dëgjojnë një zë jo kundërshtues apo refuzues arbitrar, por një zë të këshillës dhe të sugjerimit për të avancuar proceset. Ndërkaq qytetari ka fituar një zë të sigurt, një vlerësim bindës për zhvillimet brenda institucioneve komunale duke mësuar kështu më mirë se kah dhe ku harxhohet paraja publike, apo si janë caktuar prioritetet e projekteve.

Gjatë punës së tij YAHR-i ka hasur edhe në bashkëpunime të hapura të singerta dhe transparente dhe shih për këtë i falënderon të gjithë ata që kanë ofruar të dhëna dhe sqarime në çdo moment, për ne shumë të nevojshme dhe të domosdoshme për të kryer misionin tonë prej monitoruesi.

Vendimmarrja e cila prekë interesat e qytetarëve duhet të merret sa më afër tyre, këtë e siguron parimi i subsidiaritetit. Kjo u mundëson qytetarëve që të përfitojnë shërbime publike më të mira dhe në mënyrë më efikase dhe transparente nga organet komunale.

Bekim Krasniqi
Drejtor ekzekutiv i YAHR-it

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t'iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit bazuar në monitorimin e punës së Komunës së Lipjan gjatë periudhës Korrik - Dhjetor 2016. Monitorimi është fokusuar në Ekzekutivin e Komunës, dhe përfshinë fushat: e premtimeve të kryetarit të komunës, transparencës dhe llogaridhënies, demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, zhvillimit urban e ekonomik, arsimit dhe shëndetësisë. YAHR-i gjatë përpilimit të këtij raporti është bazuar në bazë të informatave të mbledhura në teren nga qytetarët, nga raportet mujore dhe vjetor i kryetarit për vitin 2016, nga monitorimi i drejtpërdrejtë të aktiviteteve të punës së ekzekutivit, nga mediat dhe nga shumë informacione të ndryshme.

Ekzekutivi i Komunës së Lipjanit edhe gjatë kësaj periudhe Korrik - Dhjetor 2016 është përballur me shumë vështirësi. Vështirësitë më të cilat është përballur ekzekutivi i Komunës së Lipjanit janë të njëjta që nga fillimi i mandatit në vitin 2014.

Në këtë raport monitorues kemi paraqitur edhe performancën e kryetarit të Komunës së Lipjanit Imri Ahmeti lidhur me përmbushjen e premtimeve gjatë fushatës zgjedhore për kryetar komune në vitin 2013 i cili kishte premtuar 131 projekte konkrete për 62 vendbanime të Komunës së Lipjanit. Organizata YAHR për të qenë sa më objektiv në vlerësimin e premtimeve, ka organizuar një vargë takimesh me qytetarë, subjekte politike, përfaqësues të fshatrave, shoqërinë civile dhe mediat. Pas analizimit të burimeve të lartpërmendura kemi ardhur deri tek këto të dhëna: Ku nga 131 premtime të premtuar me projekte konkrete gjatë fushatës në zgjedhjet lokale 2013 për kryetar të komunës së Lipjanit, kemi vetëm 43 premtime ose 32.82 % të realizuar plotësisht, ndërsa 28 premtime / projekte ose 21.37 % ka lëvizje ose ka ngecje në realizimin e tyre dhe 60 premtime ose 45.80 % nuk kemi asnjë lëvizje konkrete në realizimin e tyre.

Gjatë vitit 2016 janë shpallur 111 tenderë, nga të cilat i kemi 13 tenderë ose 11.71 % prej tyre të ritenderuar dhe 93 kontrata të nënshkruara nga operator të ndryshme duke filluar prej furnizimeve me material shpenzues për zyre deri tek investimet kapitale. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas publikimeve në faqen e KRPP-së¹ është 4,831,863.66 €, ndërsa buxhet i planifikuar për investime kapitale është 3,079,840 € që do të thotë komuna e Lipjan është në borxh ndaj operatoreve tjerë për vitet

¹ https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=SearchNotices&stat=2&PPRCMenu_OpenNode=79

në vazhdim 1,752,023.66 €, duke mos llogaritur edhe obligimet e bartura nga vitet në vazhdim dhe mendohet se Komuna e Lipjanit është në obligime diku afër 7 milionë euro ndaj operatoreve tjerë. E gjithë kjo nuk mundet të llogaritet si një menaxhim jo i mirë i parasë publike.

Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit ndaj qytetareve, ende po vazhdohet me një nivel të ultë në këto dy shtylla të qeverisjes së mirë, pasi që kryetari Imri Ahmeti vazhdon ti mbaj të mbyllura dyert për organizatat e shoqërisë civile në mbledhjet e Bordit të drejtorëve, vazhdohet me mos dërgimit të materialeve të kuvendit për organizatën tonë. Ndërsa, kemi një ndryshim krahasuar me raportin e kaluar rreth mos lejimit në qasjen në dokumentet publike për organizatën tonë, tani na është lejuar në tri raste. Po ashtu pas presionit të vazhdueshëm dy vjeçar nga ana e shoqërisë civile e kemi detyruar ekzekutivin që ti bëjë publikime vendimet për ndarje të subvencioneve nga zyra e kryetarit , pas mos publikimi dy vjeçare të këtyre vendimeve.

Ndërsa, si shenja pozitive për këtë periudhë është vazhdimi i performancës së mirë në arkëtimin e të hyrave vetanake nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe në uljen e obligimeve të borxheve të trashëguara, fillimi i realizimit të projektit nga organizata Helvitas për rregullimin dhe mbjelljen e drunjve në qytetin e Lipjanit.

Profili i Kryetarit Imri Ahmeti



Imri Ahmeti u lind më 05.08.1964, në fshatin Torlnë, komuna e Lipjanit, shkollën fillore e kreu në fshatin Rufc, ndërsa shkollën e mesme në Lipjan. Është i diplomuar në fakultetin juridik në Universitetin e Prishtinës.

Profesor i Lëndëve Juridike në gjimnazin në Lipjan 1994-1999, Shef i Inspektoratit 1999-2000, Shefi i sektorit për regjistrimin e bizneseve 2004-2007, Kryeshef Ekzekutiv 2004-2007, Këshilltar politik në Kabinetin e Presidentit të Kosovës 2007-2008, Këshilltar i lart politik i Zëvendës së kryeministrit të Qeveris së Kosovës z. Ramë Manaj 2008-2010, zv/ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme në Qeverinë e Republikës së Kosovës 2010, Deputet në Parlamentin e Kosovës 2011-2013, Nga viti 2013 kryetar i Komunës së Lipjanit².

Premtimet e Kryetarit Imri Ahmeti

Organizata Joqeveritare **Youth Association For Human Rights – YAHR** kemi monitoruar aktivitetet dhe premtimet e kryetarit Imri Ahmeti, të dhëna gjatë fushatës zgjedhore në periudhën 15 tetor – 14 nëntor 2013 dhe 7 – 12 dhjetor 2013³. Si rezultat i monitorimit tonë të bërë në mediat e shkruara dhe elektronike, si dhe në debatin e organizuar nga ne dhe gjithashtu nga dy debatet të mbajtura në “Jeta në Kosovë”⁴, në mes të tjerash Kryetari Ahmet ka premtuar:

² <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>

³ <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>

⁴ <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>

Tabela 1: Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit për realizimin e premtimeve.

0 -regon që asnjë përpjekje ose angazhim konkret nuk është bërë në realizimin e premtimit, 1- tregon se ka shenja pozitive në realizimin e premtimit, 2- tregon një proces të filluar në realizimin e premtimit por me ngecje, 3- tregon për një proces të filluar dhe në rrugë të mirë, 4- tregon se hapa konkrete kanë filluar të ndërmerren për realizimin e premtimit dhe diçka në këtë kontekst është bërë dhe, 5- tregon se realizimi i premtimit është në fazën drejt finalizimit.	vlerësimi ⁵
Lipjan	
Asfaltimi dhe ndërtimi i trotuareve në të gjitha rrugët urbane;	5
Rindërtimi i Sheshit Adem Jashari;	1
Shtimi i hapësirave gjelbëruese dhe mirëmbajtja e atyre ekzistuese;	5
Fasadimi, izolimi dhe restaurimi i ndërtesave në qytet (bashkëfinancim);	0
Ndriçimi i të gjitha rrugëve, opsioni ndriçimi solar;	3
Ndërtimi i hapësirave të hapura sportive si dhe rregullimi i Stadiumit të qytetit;	4
Ndërtimi i impiantit të ujërave të zeza;	0
Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve;	0
Ndërtimi i objektit të ri të Komunës	0
Ndërtimi i rrugës për në varrezat e qytetit dhe mirëmbajtja e tyre;	5
Ndërtimin e qendrës zejtare përmes partneritetit publiko privat;	0
Projektimi dhe ndërtimi i nxehjes qendrore përmes partneritetit publiko privat;	0
Dislokimi tregut të gjelbër dhe ndërtimi në një hapësirë të përshtatshme;	0
Rregullimi i shtratit të lumit “Sitnica” dhe përroskës “Janjevka”.	4
Projektet në Gadime të Epërme, Gadime e Ulët, Babush i Muhaxherëve, Vrellëe Gadimes, Plitkoviq, Gllavicë e Marec	
Funksionalizimi i rrjeteve ekzistuese dhe përfundimi ndërtimit të kanalizimit dhe ujësjellësit,	5
Asfaltimi i rrugicave,	4
Asfaltimi i rrugëve deri te varrezat,	5
Ndërtimi i urës dhe asfaltimi i rrugicave ne lagjen e ashkalive në Gadime të Ulët,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimi publik në rrugët qendrore, opsion ndriçimi solar.	5
Funksionalizimi dhe pajisja e ambulancës ekzistuese me laborator në Gadime të Epër,	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitorës në Gadime të Epër dhe në Gadime të Ulët,	5
Ndërtimi i rrugës Gadime- Smallushe- Sllavi,	3
Ndërtimi i shkollës fillore ne lagjen e “Ibrajve” në Gadime të Epër;	0
Rregullimi i fushave sportive,	0
Ndërtimi i çerdhes se fëmijëve për regjionin e Gadimes,	0
Gjetja e lokacionit dhe ndërtimi i shkollës fillore në Gadime të Ulët	0
Gjetja e lokacionit për ndërtimin e fushës sportive në Gadime të Ulët,	0

⁵ <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-per-Vitin-2014.pdf.aspx>

Rregullimi i stadiumit dhe i infrastrukturës përkatëse në Babush të Muhaxhirëve;	0
Rregullimi i nxehtës qendrore dhe ndërtimi i sallës së sportit për shkollën “Ernest Koliqi” në Babush të Muhaxhirëve.	1
Asfaltimi i rrugës Babush – Cernille përmes bashkëpunimit ndër komunal;	0
Projektet në Llugaxhi, Gumnasellë, Çallapek, Banullë, Glogovc, Rubovc dhe Kojksë	
Ndërtimi i trotuareve,	5
Përfundimi i objektit të sporteve në Llugaxhi,	5
Mirëmbajtja dhe rregullimi i impiantit të ujërave të zeza për fshatrat Llugaxhi, Gumnasellë. Çallapek, Banullë, Rubovc dhe Kojksë;	0
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	5
Përfundimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	5
Ndërtimi i shkollës në Gumnasellë dhe Rubovc si dhe përfundimi i shkolles në Banullë dhe në Glogovc;	5
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	4
Ndërtimi i fushave të sportit,	0
Renovimi i shkollës së vjetër të fshatit Banullë,	0
Projektet në Slllovi dhe Smallushë	
Hapja dhe asfaltimi i rrugës ndërlidhëse ndërmjet dy rrugëve kryesore të fshatit Slllovi;	4
Asfaltimi i rrugës në lagjen e “Abazve” në Slllovi;	5
Asfaltimi i rrugës ndërlidhëse Slllovi- Smallushë;	4
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martirëve në Slllovi;	4
Ndërtimi i trotuareve dhe i ndriçimit publik-opcion ndriçimi solar;	0
Zgjerimi dhe përfundimi i rrjetit të kanalizimit;	4
Rregullimi i fushës së sportit;	5
Funksionalizimi i QMF.	5
Rregullimi i sallës së sporteve në shkollën e Slllovisë;	0
Renovimi dhe funksionalizimi i shkollës së vjetër në Slllovi;	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve;	5
Ndërtimi i rrugës Slllovi – Gjilan në bashkëpunim ndërkomunal;	3
Projektet në Janjevë, Akllap, Teqe, Brus, Tërbufc, Hanroc, Bukovicë, Okosnicë, Shisharkë dhe Vogaçicë	
Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugëve të brendshme me kupëza në Janjevë,	5
Përfundimi i asfaltimit të rrugëve në Brus,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik (opcion ndriçimi solar) në Janjevë,	1
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Janjevë,	0
Funksionalizimi i ujësjellësit,	5
Ndërtimi i kanalizimit,	5
Ndërtimi i fushave të sportit,	0
Rregullimi i rrethojës së oborrit të shkollës në Janjevë,	0
Ndërtimi i shkollës në Teqe,	0
Renovimi i shkollës në Brus,	5
Ndërtimi i dy urave në fshatin Akllap,	0
Projektet në Konjuh:	
Asfaltimi i rrugëve të fshatit;	0

Ndërtimi i trotuareve;	4
Ndërtimi i rrethojës së shkollës;	5
Ndërtimi i fushës së sportit;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitores.	1
Projektet në Jetën e Re dhe Grackë e Vjetër	
Zgjerimi dhe funksionalizimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në të dy fshatrat;	0
Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve në Jetë të Re dhe Grackë e Vjetër;	0
Lidhja e ujërave të zeza të fshatit Jeta e Re dhe Grackë e Vjetër me impiantin e qytetit të Lipjanit;	0
Restaurimi dhe funksionalizimi i shtëpisë së kulturës në Grackë të Vjetër;	0
Projektet në Toplican, Grackë e Vogël dhe Bujan	
Përfundimi dhe funksionalizimi i kanalizimit.	5
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit,	0
Asfaltimi i rrugëve dhe ndërtimi i trotuareve.	5
Asfaltimi i rrugës lidhëse ndërmjet Toplicanit dhe Grackës së Vogël;	1
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Toplican;	0
Projektet në Bregu i Zi dhe Varigoc	
Ndërtimi i shkollës fillore në Breg të Zi;	0
Ndërtimi i fushës së sportit në Breg të Zi;	0
Asfaltimi i rrugicave në Breg të Zi;	5
Ndërtimi i trotuareve në Breg të Zi;	0
Asfaltimi i rrugës në Varigoc;	0
Asfaltimi i rrugës Varigoc-Godanc	0
Ndërtimi i ujësjellësit dhe kanalizimit ;	0
Projektet në Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Rufci i Vjetër dhe Ribar i Vogël	
Funksionalizimi dhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit,	2
Asfaltimi i rrugicave,	5
Ndërtimi i trotuareve,	5
Ndërtimi i urës mbi lumin Sitnica,	0
Rregullimi i fushave sportive.	0
Projektet në Kraishtë:	
Përfundimi i shkollës me objekte përcjellëse;	5
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	4
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit;	0
Përfundimi i asfaltimit të rrugicave;	0
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitores në Kraishtë;	0
Ndërtimi i trotuareve,	0
Projektet në Ribari i Madh dhe Zllakuqan	
Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit,	0
Asfaltimi i rrugëve,	5
Ndërtimi i trotuareve,	5
Rregullimi dhe mirëmbajtja e varrezave të dëshmorëve dhe martireve;	4

Ndërtimi i QMF-se në Ribar të Madh;	0
Ndërtimi i fushës të sportit.	5
Rregullimi i shtratit të lumit dhe shëtitorës në Ribar të Madh.	0
Projektet në Torinë, Poturovc, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë	
Ndërtimi dhe funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimit,	4
Asfaltimi i rrugëve të fshatrave,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik*opsion ndriçimi solar),	3
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Dobrajë të Madhe,	0
Asfaltimi i rrugëve deri te varrezat e fshatit,	5
Rregullimi i ngrohjes qendrore në objektin e shkollave.	5
Rregullimi i shtratit të lumit dhe ndërtimi i shëtitorës në Dobrajë të Madhe,	5
Ndërtimi i rrugës Dobrajë e Madhe – Magure,	5
Rregullimi i rrethojave dhe rregullimi i oborreve të shkollave,	5
Ndërtimi i rrugës regjionale Llugë- Radeve,	0
Projektet në Magurë, Mirenë, Medvec, Qylagë, Vërshec, Leletiq, Blinajë dhe Vrellë e Goleshit	
Asfaltim i rrugëve,	5
Asfaltimi i rrugës Vërshec-Qylagë,	5
Ndërtimi i stadiumit dhe objekteve përcjellëse në Magure,	0
Asfaltimi i rrugës së varrezave në Medvec,	5
Ndërtimi i trotuareve dhe ndriçimit publik të rrugëve qendrore,	3
Funksionalizimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve,	5
Ndërtimi i shkollës në Magure dhe Mirenë,	1
Ndërtimi i Qendrës Rinore në Magure,	3
Renovimi i shtëpisë së kulturës në Vrellë,	0
Dhënia e lokacionit dhe ndërtimi i objekteve të banimit social përmes partneritetit publiko privat në Magure,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Rregullimi i shtratit të lumit në Magure dhe rregullimi i parkut-shëtitorës,	0
Projektet në Shalë, Kroimir, Baicë, Resinoc, Kleçkë dhe Divjakë	
Asfaltimi i rrugicave,	3
Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë,	5
Zgjerimi dhe riasfaltimi i rrugës në Resinoc,	0
Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimit,	4
Ndriçimi publik i rrugëve qendrore,	0
Rregullimi i shtratit të lumenjve,	0
Ndërtimi i terreneve sportive,	0
Përfundimi i sallës së sportit në Shalë,	4

- 60 premtime ose 45.80 % pa asnjë përpjekje ose angazhim konkret në realizimin e premtimit,
- 6 premtime ose 4.58 % ka shenja pozitive në realizimin e premtimit
- 1 premtime ose 30.76 % ku procesi ka filluar në realizimin e premtimit por me ngecje,
- 7 premtime ose 5.34 % procesi ka filluar në rrugë të mirë,

- 14 premtime ose 10.68 % ka hapa konkrete në realizimin e premtimeve,
- 43 premtime ose 32.82 % të realizuar plotësisht.

Vërejtje: Premtimet janë për periudhën katër vjeçare 2013/2017. Deri tani është shpenzuar $\frac{1}{4}$ e kohës dhe kanë mbetur edhe $\frac{3}{4}$ e kohës së mandatit .

Grafiku 1. Vlerësimi i përgjithshëm i angazhimit dhe përpjekjes së Kryetarit IMRI AHMETI për realizimin e premtimeve



Grafiku 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve





Tabela 2. Vlerësimi i realizimit të premtimeve sipas vendbanimeve

Vendbanimet	Totali i premtimeve	Premtimet e plotësuar	%	Në realizim	%	Të pa realizuara	%
Qyteti I Lipjanit	14	3	21.42%	4	28.57%	7	50%
Gadime të Epërme, Gadime e Ulët, Babush i Muhaxherëve, Vrellëe Gadimes, Plitkoviç, Gllavicë e Marec	16	5	31.25%	3	18.75%	8	50%
Llugaxhi, Gumnasellë, Çallapek, Banullë, Gllgovc, Rubovc dhe Kojskë	9	5	55.55%	1	11.11%	3	33.33%
Sllovi dhe Smallushë	12	4	33.33%	5	41.66%	3	25%
Janjevë, Akllap, Teqe, Brus, Tërbufc, Hanroc, Bukovicë, Okosnicë, Shisharkë dhe Vogaçicë	11	5	45.45%	1	9.09%	5	45.45%
Konjuh:	5	1	20%	2	40%	2	40%
Jetën e Re dhe Grackë e Vjetër	4	0	0%	0	0%	4	100%
Topliçan, Grackë e Vogël dhe Bujan	5	2	40%	1	20%	2	40%
Bregu i Zi dhe Varigoc	7	1	14.28%	0	0%	6	85.71%
Hallaq i Madh, Hallaq i Vogël, Rufci i Ri, Rufci i Vjetër dhe Ribar i Vogël	5	2	40%	1	20%	2	40%
Kraishtë:	6	1	16.66%	1	16.66%	4	66.66%
Ribari i Madh dhe Zllakuqan	7	3	42.85%	1	14.28%	3	42.85%
Torinë, Poturovc, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Llugë dhe Gllanicë	10	6	60%	2	20%	2	20%
Magurë, Mirenë, Medvec, Qylagë, Vërshet, Leletiq, Blinajë dhe Vrellë e Goleshit	12	4	33.33%	3	25%	5	41.66%
Shalë, Kroimir, Baicë, Resinoc, Kleçkë dhe Divjakë	8	1	12.5%	3	37.5%	4	50%
Totali	131	43	32.82%	28	21.37%	60	45.80%

Grafiku 3. Dinamika e realizimit të premtimeve nëpër vite 2014-2016



Problemet aktuale

Sikur se edhe në raportet e kaluara monitoruese Komuna e Lipjanit nuk po arrin kurrë se si ti zgjidhë problemet kryesore që po preokupohen qytetarët e Lipjanit, në këtë nuk e ka pas arritur as ekzekutivi i kaluar, por edhe ekzekutivi tanishëm nuk ka bërë as ndonjë përpjekje serioze në zgjidhjen e tri problemeve kryesore që sot qytetarët e Lipjanit preokupohen dhe ato janë:

- Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre
- Mungesa e ngrohtores së qytetit;
- Kundërmimi nga ferma e pulave;

Problemi me ujërat e zeza si pasoj i mos trajtimit të tyre: Komuna e Lipjanit është duke u përballur me një problem që dita ditës është duke u zgjeruar, i mos trajtimit të ujërave të zeza. Gjatë viteve të kaluara janë rregulluar një numër i sistemeve të kanalizimeve pa trajtimin e ujërave të zeza, pra pa kolektor, pa impiante për trajtim dhe këto ujëra janë derdhur drejtpërdrejtë në lumin Sitnica apo edhe nëpër fusha dhe livadhe. Këto ujëra të derdhura gjithnjë e më shumë po ndikojnë në ndotjen e ambientit jetësor dhe janë duke ndikuar edhe në shëndetin e qytetarëve.

Mungesa e ngrohtores së qytetit. Nuk ka lëvizje në këtë drejtim, edhe pse ne kemi bërë vërejtje që nga raporti e parë mbi punën e ekzekutivit të Komunës së Lipjanit dhe që është premtim më kryesor nga fushata zgjedhor që nga 2009-ta dhe 2013-tës nga kryetari i komunës Z. Imri Ahmeti.

Kundërmimi nga ferma e pulave. Banorët në dalje të qytetit të Lipjanit, në drejtim të fshatit Banullë, kanë problem kundërmimit e erërave që vijnë nga ferma e pulave që ndodhet në afërsi të udhëkryqit për në Janjevë. Nga erërat që fryjnë, kundërmimi nga ferma e pulave mbërrin deri në qendër të qytetit, por më së shumti kanë problem banorët që ndodhen në afërsi të kësaj ferme.

Transparenca dhe llogaridhënia

Ndër premtimet kryesore të Kryetarit Imri Ahmeti ka qenë edhe transparenca dhe llogaridhënia si dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e ekzekutivit ndaj qytetareve, ende po vazhdohet me një nivel të ultë në këto dy shtylla të qeverisjes së mirë, pasi që kryetari Imri Ahmeti vazhdon ti mbaj të mbyllura dyert për organizatën e shoqërisë civile YAHR në mbledhjet e Bordit të drejtorëve, vazhdohet me mos dërgimit të materialeve të kuvendit për organizatën tonë. Ndërsa, kemi një ndryshim krahasuar me raportin e kaluar rreth mos lejimit në qasjen në dokumentet publike për organizatën tonë, tani na është lejuar në tri raste. Po ashtu pas presionit të vazhdueshëm dy vjeçar nga ana e shoqërisë civile e kemi detyruar ekzekutivin që ti bëjë publikime vendimet për ndarje të subvencioneve nga zyra e kryetarit, pas mos publikimi dy vjeçarë të këtyre vendimeve. Në ueb faqja e komunës ekzistojnë mangësi në vonesën e informimit të qytetareve dhe mungesën e informacioneve tek profilet e këshilltareve komunal.

Performanca buxhetore e komunës së Lipjanit

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Lipjanit për periudhën Janar-Tetor 2016 ka arrit që të shpenzohet në masën 82.47% ose 9,416,256.81€ nga buxheti i alokuar prej 11,418,423.03 € ose 69.06 % nga buxheti i përgjithshëm i komunës për vitin 2016, që është 13,634,445.95 €. Kjo shifër është e mirë e arritur në

shpenzimin e buxhetit për periudhën dhjetë mujore në këtë komunë. Mirëpo, pjesa më e madhe e pritët të shpenzohen në tre mujorin e fundit të 2016.

Po ashtu e kemi një performancë të mirë edhe në inkasimin e të hyrave vetanake të komunës ku deri në fund të muajit Tetor janë realizuar në vlerë 1,489,537.88 € ose 90.28 % nga planifikimi vjetor buxhetor që është 1,650,000.00 euro për vitin 2016. Realizimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë deri me 31.10.2016, është realizuar në vlerën 668,506.72€ ose 116.26% nga planifikimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë që është për vitin 2016 është 575,000.00€. Planifikimi i të Hyrave nga Qiraja deri me 31.10.2016 është realizuar në vlerën prej 23,336.30 € ose shprehur në përqindje 19.29% nga planifikim 121,000.00 € për vitin 2016 . Planifikimi i të Hyrave nga Lejet Ndërtimore deri me 31.10.2016 është realizuar 268,583.98€ ose 134.29%. nga planifikimi për vitin 2016 në vlerën prej 200,000.00€. Planifikimi i të Hyrave nga Tregjet deri 31.10.2016, janë realizuar në vlerën 22,831.20€ ose 57.08%. nga planifikim për vitin 2016 që është 40,000.00€, Të hyrave nga Shfrytëzimi i Pronave Publike deri më 31.10.2016 është 4,602.29€ ose 92,05% nga planifikimi për vitin 2016 që është 5,000.00€.

Grafiku 4. Të hyrat komunal nga lloji i burimit



Tabela 3. Buxheti komunal i planifikuar 2016

Kategoria	shuma	%
Paga dhe Meditje	8,658,911.00 €	66.36%
Shpenzimet Kapitale	3,079,840.00 €	23.60%
Mallra dhe Shërbime	782,630.00 €	6.00%
Subvencionet dhe Transferet	329,067.00 €	2.52%
Shpenzimet Komunale	198,390.00 €	1.52%

Tabela 4. Buxheti komunal 2003/2016

Viti	Rrogat dhe meditet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transfere	Shpenzimet kapitale	Gjithsej
2016	8,658,911 ▲	782,630 ▼	198,390 ■	329,067 ▲	3,079,840 ▲	13,634,445 ▲
2015	8,297,000 ▲	956,030 ▼	198,390 ▼	157,000 ▼	2,790,834 ▼	12,399,254 ▲
2014	6,793,498 ▲	983,145 ▲	256,500 ▼	200,000 ▲	3,100,301 ▼	11,333,444 ▼
2013	6,738,235 ▲	815,573 ▲	204,746 ▲	179,550 ▲	3,301,197 ▼	11,973,991 ▲


2012	6,744,398 ▲	742,386 ▼	119,972 ▼	138,064 ▲	3,606,440 ▼	11,795,467.76 ▲
2011	6,580,682 ▲	752,815 ▲	130,707 ▼	88,273 ▲	4,113,220 ▲	11.317.613,69 ▲
2010	5,069,000 ▲	698,000 ▲	133,000 ▼	78,000 ■	3,376,000 ▲	9,456,417 ▲
2009	4,425,264 ▲	512,394 ▼	112,154 ■	80,000 ■	2,325,154 ▲	7,454,966 ▲
2008	3,868,282 ▲	554,288 ▲	112,154 ▼	80,000 ■	1,239,909 ▲	5,854,633 ▲
2007	3,718,294 ▼	537,335 ▼	202,154 ▲	80,000 ▼	1,127,138 ▲	5,664,921 ▲
2006	3,731,341 ▲	610,147 ▼	78,577 ▼	100,000 ▲	1,070,849 ▼	5,590,914 ▼
2005	3,696,996 ▼	621,827 ▼	126,381 ■	64,000 ■	1,180,077 ▲	5,689,281 ▲
2004	3,701,207 ▲	1,135,854 ▼	-	-	721,431 ▲	5,558,492 ▲
2003	2,770,014 ■	1,144,006 ■	-	-	465,113 ■	4,528,532 ■

▲ Rritje, ▼ Zvogëlim, ■ Nivel i njëjtë/mos ndryshim

Drejtoria e prokurimit

Drejtoria Komunale e Prokurimit gjatë kësaj periudhe raportuese ka filluar mirë. Gjatë periudhës Janar-Nëntor 2016, kemi mbi 111 tenderi të shpallura nga të cilat kemi 13 tenderë ose 11.71 % të ri-tenderuar dhe 93 kontrata të nënshkruara nga operator të ndryshme duke filluar prej furnizimeve me material shpenzues për zyre deri tek investimet kapitale. Vlera e kontratave të nënshkruara sipas publikimeve në faqen e KRPP-së është 4,831,863.66 €, ndërsa buxhet i planifikuar për investime kapitale është 3,079,840 € që do të thotë komuna e Lipjan është në borxh ndaj operatorëve tjerë për vitet në vazhdim 1,752,023.66 €.

Grafiku 5. Aktivitetet e Drejtorisë Komunale të Prokurimit



Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur 6 ankesa të konkurrenës në tendera tek Organi Shqyrtues i Prokurimit. Kemi dy aktivitete të anuluar nga OSHP-ja, me 27 Janar 2016 lidhur me Përzgjedhjen e kompanisë projektuese-projektim të kanalizimeve, rrugëve, ujësjellësve, planeve zhvillimore-urbane në KK Lipjan, pastaj me 09 Qershor 2016 lidhur me mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve të institucioneve Komunale ku kjo lënda është kthyer në ri-tenderim nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Tabela 5. LISTA E TËNDERVE TË KONTRAKTUARA NGA DREJTORIA KOMUNALE E PROKURIMIT NË LIPJAN GJATË PERIUHËS JANAR-NËNTOR 2016⁶

Nr.	Nr. i prokurimit	Titulli	Fituesi	Shuma e kontraktuar
1	LI613-16-013-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve në fshatin Ribar i Vogël	NTP."Ferizi"	41.564.50.€
2	LI613-16-020-5-2-1	Ndërtimi i fushave te vogla sportive ne fshatrat Kraishtë, Glogovc, Ribar i Madh dhe SHFMU „ Ismajl Luma" në Lipjan	NNP " ATC COM"Kaçanik	70,126.53 €
3	LI613-16-012-1-2-1	Furnizimi me inventar për shtëpinë e komunitetit	NTP"Burimi Dekor"	9,703.60 E
4	LI613-16-009-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve Blinajë- Qylagë	Papengurg&Adriani	30,557.00 €
5	LI613-16-021-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Glllogoc	NPSH "Bageri"	40,234.83 €
8	LI613-16-010-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve Glllogoc- Banullë	NPSH "Bageri"	24,502.26 €
9	LI613-16-008-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Magurë	Bageri Copany	35,169.60
10	LI613-16-005-1-2-1	Furnizim i institucioneve arsimore dhe shëndetësore me material higjenik	Konz.SH.P.K "PM GROUP"&BENI DONA PLAST" PRISHTINË	36,502.50 €
11	LI613-16-011-1-3-6	Furnizimi me plehra të ndryshme minerale për ekonominë bujqësore SHMP "Adem Gllavica" në Lipjan	"Semenarna" shpk Lipjan	3,995.00€
12	LI613-16-003-2-2-1	Furnizim me goma dhe akumulator për nevoja të Institucioneve Komunale	Allmakes Global Services N.p.sh - Fushë Kosovë	22,169.92 €
13	LI613-16-006-1-3-6	Furnizimi me dru për nevoja të shkollave	NTP : "Jeta" Prishtinë	3230.00 €
14	LI613-16-109-4-2-1	Përzgjedhja e kompanisë projektuese - projekte të kanalizimeve, rrugëve, ujësjellësve, plane zhvillimore - urbane në Komunën e Lipjanit	"NNP Arhiko-ing & NPSH Hidroprojekt" Prishtinë	2,83 €
15	LI613-16-121-2-2-1	Sigurimi i objekteve të institucioneve komunale	"Rojet e Nderit" Prishtinë	86,724.00€
16	LI613-16-122-2-2-1	Mirëmbajtja dhe pastrimi i objekteve të Institucioneve Komunale	NTSH AB-clean-AB-Dienstleistung GmbH	79,919.56€
17	LI613-16-047-5-2-1	Zhavorrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në tërë Komunën e Lipjanit	NNSH"Xhema Com"	42.769.10 €
18	LI613-16-039-1-2-1	Furnizimi dhe montimi i xhamave nëpër shkolla dhe institucione të tjera të Komunës së Lipjanit	"Bali Commerce" shpk	11,352.40 €_
19	LI613-16-055-5-3-6	Rregullimi i oborrit në shtëpinë e komuniteteve	konz."Bereqeti ING & Brezi Kufitar"	4935.00
20	LI613-16-048-5-2-1	Asfaltimi i rrugës Dobrajë e Madhe- Qylagë	NPSH "Bageri"	85,575.56 €
21	LI613-16-046-5-3-6	Renovimi i njeve sanitare ne shkollën e mesme Gjmnazi Ulpiana	NN.Global Ing	4746.50
22	LI613-16-040-5-2-1	Rregullimi i Shtratit të Lumit në fsh. Gadim - Faza II	Ledi Ing "SHPK	98.171.44.€
23	LI613-16-042-1-3-6	Furnizimi me material dhe pajisje për funksionalizimin e kabineteve në lëndët: Biologji, Kimi, Fizik, Elektro, Makineri.	NTP "Euro Lab"	9,839,13 €
24	LI613-16-029-2-2-1	Mirëmbajtja e rrjeteve të kanalizimeve në tërë Komunën e Lipjanit	NNSH "Xhema Com" - Lipjan	39,223.91 €
25	LI613-16-016-5-2-1	Asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës në varrezat e fshatit Medvec	SHPK: "Eskavatori"	27.461.20.€

⁶ Shënimet janë marrë nga ueb faqja zyrtare e KRPP-së (Komisionit Rregullator të Prokurimit Publik të Kosovës) deri në ora 01.34 të datës 28.11.2016.

26	LI613-16-041-1-3-6	Furnizimi me veshmbathje dhe tepih për shtëpinë e komuniteteve	NTSH "Meteor"	5,484.80 €
27	LI613-16-035-5-2-1	Mirëmbajtja investive në hapësirat publike	Konzorcium "Kema Company" & "Brezi Kufitar" - Lipjan	46,948.44 €
28	LI613-16-031-2-3-6	Transporti i nxënësve dhe administruesve ne relacione te ndryshme shkollë-Lipjan dhe anasjelltas - Lloti 1dhe Lloti 2	- SHPK.Lipjani per Llotin 1 - Titi Turs per Llotin 2	1,030.60 € .605.80 €
29	LI613-16-028-1-2-1	Ilot -1, Furnizimi me veshmbathje dhe tepih Ilot -2 furnizimi me material higjenik dhe Ilot -3 furnizimi me artikuj ushqimor për shtëpinë komuniteteve	Beni dona Plast	3,583.10 € 11,153.38€
30	LI613-16-007-5-2-1	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatin Mirenë – faza e parë	NNSH "Xhema Com"	32,611.25 €
31	LI613-16-027-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve ne fshatin Banullë	"Dimi Bau"	33,959.39 €
32	LI613-16-023-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve ne fshatin Glogoc	NTP "Rexha Com"	30,435.60 €
33	LI613-16-015-5-2-1	Hapja dhe zhavorimi i rrugës Hallaq i Madh – Ruvç i Ri	NNP "XHEMA COM"- LIPJAN	13,798.00 €
34	LI613-16-026-5-2-1	Ndërtimi i rrethojës në SHFMU."Ernest Koliqi"në Babush i Muhaxherve	NPSH."Topalli"	11.871.50.€
35	LI613-16-022-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve në fshatin Ribar i Madh	NSHP"DIMI-BAU"	24,845.20 Euro
36	LI613-16-014-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve ne fshatin Magure	NNSH „XHEMA COM” ,Lipjan	18,874.60 €
37	LI613-16-018-5-2-1	Ndërtimi i Qendrës Rinore në fshatin Magurë-faza II	EN GRUP SHPK	304.741.44.€
38	LI613-16-019-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve në fshatin Ruvç i Vjetër	N.T.P "Rexha Com"	19,844.72 €
39	LI613-16-001-2-2-1	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve Komunale	NTSH "BEKA" Gjyrovç, Shtime	45,185.00 €
40	LI613-16-047-5-2-1	Zhavorimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në tërë Komunën e Lipjanit	NNP "XHEMA COM"- LIPJAN	42.769.10 €
41	LI613-16-031-5-2-1	Ndërtimi i trotuareve ne fshatin Llugaxhi	Konz. Kryeziu & Global Ing	27.700.59.€
42	LI613-16-044-5-3-6	Renovimi i kulmit (ulluqet) në çerdhen e fëmijëve -Lipjan	"Detari SHPK"	1600.00
43	LI613-16-050-5-2-1	Rregullimi i Shtratit të Lumit në fsh. Banullë	Lindi Nsh	43,844.24 €
44	LI613-16-036-5-2-1	Hapja dhe pastrimi i Lumit Sitnica	Ardi	75,043.00 €
45	LI613-16-033-5-2-1	Përmirësimi i hapësirave publike – faza e dytë	NNT"Eing Com"	137.160.60 €
46	LI613-16-034-2-2-1	Mirëmbajtja e parqeve, parkingjeve dhe hapësirave tjera publike në Qytetin e Lipjanit	NNT"Eing Com & Ve-Mor"SHPK	79.264.06 €
47	LI613-16-037-1-2-1	Furnizim me serra, pre 1 ari, me sistem të ujitjes	"DST Product" Ferizaj	44,620.00 €
48	LI613-16-054-1-2-1	Asfaltimi i rrugëve brenda qytetit të Lipjanit	Gashi ING	232,885.84 €
49	LI613-16-049-2-2-1	Eliminimi i deponive të egra në tërë territorin e Komunës së Lipjanit	Nnsh"Xhema com"	39,593.08 €
50	LI613-16-056-5-3-6	Renovimet e disa shkollave të Komunës së Lipjanit	"Dini-St"shpk	4725.00 €
51	LI613-16-051-5-2-1	Instalimi i ngrohjeve qendrore në disa shkolla të Komunës së Lipjanit	"Termo Vision"SHPK	199,032.84 €
52	LI613-16-053-2-2-1	Mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara	"Shkoza F07" – Prishtinë	24,999.50 €
53	LI613-16-055-5-2-1	Asfaltimi i rrugës dhe infrastrukturës në varrezat e Lipjanit	"Eing-Com"	27,964.35 €

54	LI613-16-061-1-3-6	Furnizimi me Bileta të aeroplanit për 10 persona(Prishtinë-Romë (Fiumicino)	NTSH "Jet Air Connection"	3,890.00 €
55	LI613-16-038-1-2-1	Furnizimi me fidane të mjedrrës dhe sistem të ujitjes në sipërfaqe prej 5.6 ha	"Agrium" shpk	44618.56 €
57	LI613-16-043-2-3-6	Largimi i billboardave dhe transportimi i tyre	"ASS" Shpk	1,742.86 €
58	LI613-16-024-1-2-1	Furnizimi i institucioneve shëndetsore me materjal laboratorik-Ritenderim	Biotek Kosovo LLC	29.812.41€
59	LI613-16-059-1-3-6	Implementimi i projektit E-Kioskave për shërbime të gjendjës civile	PBC SHPK	8,350.00 €
60	LI613-16-058-5-2-1	Ndërtimi i lapidarëve në varrezat e dëshmorëve dhe martirëve në Kraishtë dhe Ribar të Madh	NNSH "Loni"	22,341.03 €
61	LI613-16-063-1-2-1	Furnizimi me material të imt për mirëmbajtjen e shkollave Lot 2	Bali-Comerc	70,178.65€
62	LI613-16-070-5-2-1	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Topliqan i vjetër	NPSH "Bageri"	33,955.26 €
63	LI613-16-073-2-3-6	Renovime dhe shërbime tjera në SHMP "Adem Gllavica"- ish objekti i gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan	"AG-ER" shpk	3964.50 €
64	LI613-16-068-5-2-1	Asfaltimi i rrugës Shalë-Baicë	NNT."Burimi"	42.303.00.€
65	LI613-16-066-2-2-1	Transporti i nxënësve vendbanim - shkollë dhe anasjelltas, 10 lloje.	Titi Tours ,Nexhi Comerc""K.T.Arsim Stullca", "K.T.Amir Bytyqi", "Janjeva Trans", "Lipjani " shpk", Lipjani " ,shpk, "Autotaxi Sherif ,Shashivari " shpk, "Autotaxi Merxhan Aliu " shpk	2,627.00 €; 13,176.00 €: 28,191.15 €; 7,905.60 €; 41,422.00 €; 21,031.00 €; 16,689.60 €; 18,528.75 €
66	LI613-16-071-5-2-1	Ndërtimi i rrugicave me kubza, ne fshatin Janjevë	NTP "Rexha Com"	43,131.00 €
67	LI613-16-001-2-2-1	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve të Institucioneve Komunale	"Auto Beka" – Gjurmec-Shtime	46,576.00 €
68	LI613-16-075-1-2-1	Furnizimi me inventar për shkollë "Nezë Bujani"-Bujan dhe "Emin Duraku"-Banullë paralelja e ndarë në Gumnasellë	NTP "Metali"	19696.00 €
69	LI613-16-067-2-3-1	Instalimi dhe monitroimi i sistemit të alarmit kundër thyjes-vjedhjes	"Delta security"	5845.00 €
70	LI613-16-030-1-2-1	Furnizim me dru për ngrohje për shkollat, QKMF-në dhe shtëpinë e Kulture me pelet	NTP "Agoniti"	119,338.40 €
71	LI613-16-077-5-2-1	Asfaltimi i rrugës në fshatin Blinajë	NPSH "Bageri"	38,986.20 €
72	LI613-16-064-5-1-1	Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit	NTSH."Dino"	728,473.43.€
73	LI613-16-069-5-1-1	Ndërtimi i Sheshit Adem Jashari	Konz."Olti Trasing SHPK & Beni Com SHPK"	465,757.77 €
74	LI613-16-032-1-2-1	Furnizim me lëndë djegëse – thëngjill për ngrohje në Institucionet Arsimore dhe QKMF	NTP "Ajroni"	52,170.00 €
75	LI613-16-057-5-2-1	Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit Gadime e Ulët faza II	Eskavatori	115,868.9 €
76	LI613-16-079-5-2-1	Ndërtimi i zonës Ekonomike "Parku Industrial" në Qylagë të Komunës së Lipjanit-Faza e parë	NTSH "Dino"	149,877.34 €
77	LI613-16-074-1-3-6	Furnizimi me naftë dhe derivate të naftës për shtëpinë e Komunitetit	Hib Petroll SH.P.K	5.753.20
78	LI613-16-066-2-2-1	Transporti i nxënësve nga fshati Qallapek deri te shkollë "Emin Duraku" Banullë dhe anasjelltas lloje 8 - ritenderim	NTT "Nexhi Commerce"	10431.00 €

79	LI613-16-087-1-3-6	Furnizimi me farë gruri dhe pleh mineral për ekonominë e SHMP "Adem Gllavica" Lipjan	"Semenarna shpk"	1200.00 €
80	LI613-16-081-5-3-6	Rregullimi i Qeshmes (Currelit) dhe infrastrukturës përreth në Leletiq	NNSH "Xhema com"	6420.52 €
81	LI613-16-080-5-2-1	"Ndërtimi i fushave të hapura sportive në oborrin e shkollave të fshatit Konjuh dhe Medvec"	"NNP Lind Alb" & "Trasing Group SHPK"	36,957.73 €
82	LI613-16-082-5-2-1	Hapja dhe pastrimi i Shtratit të lumit Sitnica – Fazae II-të	NTP "Ferizi"	31,034.00 €
83	LI613-16-084-5-2-1	Ndërtimi i fushës së vogël të Sportit në Akllap	"Atc com"	19,100.95 €
84	LI613-16-083-5-2-1	Ndërtimi i Parkut ne Slovi	"ATC COM SHPK"	10.092.49 €
85	LI613-16-076-2-2-1	Servisimi i fotokopjeve në çerdhen dhe shkollat e Komunës së Lipjanit	NTSH "Rikon"	1001.00 €
86	LI613-16-072-5-2-1	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Medvec te Komuniteti RAE	: "El-Bau" shpk – Gjilan	9,165.00 €
87	LI613-16-086-2-2-1	Mirëmbajtja e ndriqimit Publik ne Qytet dhe Fshatra	NSH "MVR ELEKTROMONTUES"	28,927.00 €
88	LI613-16-085-5-2-1	Hapja dhe zgjerimi i Lumejve në fshatrat e Komunës së Lipjanit	NNP "Ardi"	28,330.00 €
89	LI613-16-088-5-2-1	Zgjerimi i rrjeteve të kanalizimeve në Slovi, Gadime e Ulët, Lipjan, Dobraj e Vogël, Dobrajë e Madhe, Marevc, Magurë dhe fshatra tjera të Komunës së Lipjanit	Shpk "Bereqeti Ing" - Prishtinë	3,999.00 €
90	LI613-16-090-1-3-6	Furnizimi me Kompjuter dhe paisje kompjuterike Llot 1 Furnizimi dhe instalimi i kamerave. Llot 2	"Tech com shpk" "Euro printy shpk"	4,025.00 € 1,063.00 €
91	LI613-16-091-2-3-6	Rregullimi i verandës si dhe mbjellja e drunjve dekorues në shtëpinë e komunitetit	Shpk "Bereqeti Ing" - Prishtinë	3,999.00 €
92	LI613-16-063-1-2-1	Furnizimi me paisje te ndryshme Llot 1 per nevoja te shkollave- Ritenderim	"NPT Euro Coop"	36.225.97 €
93	LI613-16-065-1-3-6	FURNIZIMI ME KLIMA DHE SERVISIMI	"Binaku"	3040.00 €

Arsimi

Me nisjes së mandatit të parë të kryetari aktual Imri Ahmeti, sistemi arsimor në Lipjan është përballur me këto probleme kryesore:

1. Gjendja jo e mirë e infrastrukturës shkollore;
3. Numri i madh i nxënësve për paralele në shkollat e mesme;
3. Mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik;

Po ashtu, ndër problemet tjera që janë evidentuara në këtë vit 2016, janë se pjesa dërrmuese e shkollave në Komunën e Lipjanit janë në gjendje të keqe infrastrukturore .

Problemet të cilët aktualisht hasën në sistemin arsimor në Lipjan janë ato në shkollat e mesme, përkatësisht me numrin e madh të nxënësve në to që në shumicën e rasteve ky numër është afërsisht 40 nxënës për një klasë dhe po ashtu problem në vete paraqet mungesa e laboratorëve dhe hapësirave për mësim praktik.

Tabela 6. Numri i nxënësve dhe i personelit arsimore në Komunën e Lipjanit⁷

Arsimi Komunal			Personeli		
	Nr. i institucioneve	Nr. i nxënësve	Nr. i Mësimdhënësve	Nr. i personelit administrativ	Nr. i personelit ndihmës
Institucione parashkollore publike	1	88	8	2	7
Shkolla fillore, të mesme të ultë / publike	51	9,581	668	44	113
Shkolla të mesme publike	4	2,895	88	7	13
Shkolla apo kolegje private	1	/	/	/	
Gjithsej	56				

Shëndetësia

Po ashtu është shqetësuese gjendja në sektorin e shëndetësisë, për kundër angazhimeve të shumta të Drejtorisë Komunal për Shëndetësi në Komunën e Lipjanit, që të përmirësojë gjendjen ekzistuese në sektorin shëndetësor, prapë se prapë gjendja ka qenë katastrofale në këtë sektor, me fajin e Ministrisë së Shëndetësisë. Ka pasur mungesë të gjerave elementare duke filluar nga shiringat, gypin përcjellës për infuzione, dorëzat sterilizuese për personelin mjekësorë, fashat, cilindrin mbushës me oksigjen dhe plotë gjëra të tjera që i duhen një pacienti për të marrë një intervenim emergjent. Me këtë përveç që pacient do të kishte shpenzime materiale , ata rrezikohen edhe me humbjen e kohës për të marrë ndonjë intervenim mjekësorë për shëndetin e tij dhe njëkohësisht me këtë i rrezikohet edhe jeta e tij në raste të rënda.

Pas thirrjes së organizatës sonë ndaj ekzekutivit të Komunës së Lipjanit që të angazhohet maksimalisht në kujdesin shëndetësor për qytetarët e vetë, drejtoria komunale e shëndetësisë është përgjigjur pozitivisht, duke ndarë mjete buxhetore për plotësimin e këtyre mungesave të medikamenteve e cila është si pasojë e një menaxhim të keq nga Ministria e Shëndetësisë.

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Komunën e Lipjanit përlllogariten sipas Rregullores komunale mbi pronën. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore.

Rekomandimet:

1. Angazhim më i madh i Kryetarit të Komunës në përmbushjen e premtimeve elektorale;
2. Menaxhim më i mirë dhe transparencë më e madhe në shpenzimin e fondeve publike;
3. Ofrim i qasjes në informacion dhe dokumentacion për të gjitha palët e interesuara;
4. Komunikim më kualitativ me shoqërinë civile dhe media;
5. Organizimi më i shpeshtë i takimeve publike me qytetarë veçanërisht në fazën e përpilimit të projekteve kapitale dhe buxhetit komunal;

⁷ <http://masht.rks-gov.net/uploads/2016/08/statistikat-e-arsimit-ne-kosove-shq.pdf>

6. Marrja parasysh e propozimeve të qytetarëve për investime kapitale sipas mundësive buxhetore;
7. Në fillim të vitit të paraqitet në Kuvendin Komunal, Plani Dinamik i realizimit të projekteve nga Lista e Investimeve Kapitale;
8. Mbikëqyrje më efikase e realizimit të punëve në projektet kapitale, veçanërisht në projektet infrastrukture;
9. Mbrojtje më e mirë e pronës publike mbi baza ligjore ,
10. Përmirësimi i bazës të dhënave mbi tatimin në pronë,
11. Integrimin e një programi kompjuterikë kontabiliteti të brendshëm që do të siguronte informacione për qëllime raportimi në kohë, të plotë dhe të saktë,

Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Shkurt-Qershor, 2016.
2. Ministria e Ekonomisë dhe Financave. Raportet Vjetore Financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitet 2003-2015. (<http://mefrks.org/sq/download/314-raportet-e-buxhetit-dhe-pasqyrat-financiare>);
3. Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2015-2017 – raporte të miratuara nga të gjitha Kuvendet Komunale.
4. Rregulloret Komunale për tatim në pronë – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
5. Rregulloret për taksa, gjoba dhe ngarkesa – të miratuara nga Kuvendet Komunale.
6. Debatet komunale 2013 “Jeta në Kosovë”, www.jetanekosove.com.
7. ESK. Analiza e Statistikave Vitale të Kosovës për periudhën më të re. Prishtinë, shkurt 2008.
8. UNDP. Human Development Report – Kosovo 2012.
9. Asociacioni i Komunave të Kosovës. Komunitat e Kosovës-profil i shkurtër. Qershor, 2013.
10. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-dhjetor 2013. Janar, 2014.
11. MAPL. Raport i funksionimit të Komunave të Kosovës – janar-qershor 2014. Shtator, 2014.
12. MPMS-Departamenti i Mirëqenies Sociale. Shfrytëzuesit e Ndhmës Sociale Sipas Komunave. Qershor, 2014.
13. Programi zgjedhor i LDK-së dega Lipjan , Nëntor 2013,
14. Raporti Komunal Lipjan i Institutit për studime të Avancuara GAP , 2016,
15. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Janar-Qershor 2016,
16. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit Janar-Qershor 2016 <http://kk.rks-gov.net/lipjan/Municipality/Raportet-Mujore-te-Drejtorateve.aspx> ,
17. Raporti i kryetarit për vitin 2014 <http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/President-Report/Raporti-per-Vitin-2014.pdf.aspx>.
18. Raporti i kryetarit për vitin 2015 [http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Kryetari/Raporti-i-Kryetarit/Raport-i-punes-i-Zyres-se-Kryetarit-dhe-Drejtorateve-Komunale-\(1\).pdf.aspx](http://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Kryetari/Raporti-i-Kryetarit/Raport-i-punes-i-Zyres-se-Kryetarit-dhe-Drejtorateve-Komunale-(1).pdf.aspx).
19. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Qershor 2016.
20. <https://kk.rks-gov.net/lipjan/getattachment/Municipality/President/Biografia-e-Kryetarit.pdf.aspx>,
21. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/programet-e-partive-politike-peumlr-zgjedhjet-2013.html>,
22. <http://zgjedhjet2013.weebly.com/tv-debatet.html>,

